



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА
МАКЕДОНИЈА



Në bazë të nenit 22 paragrafi 7 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 2 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i panjohur me pohime për ekzistim të konfliktit të interesit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në seancën e 54-të, vazhdimi i par i mbajtur me datë 02.11.2021 morri,

VENDIM

Denoncimi për fillimin e procedurës për përcaktimin e gjendjes së konfliktit të interesave me nr. 09-3777/1 nga 03.11.2020 e dorëzuar nga parashtrues i panjohur, REFUZOHET

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka elemente për veprim kompetent në lëndën me numër 09-3777/1 të datës 03.11.2020.

Lënda me numër 09-3777/1 të datës 03.11.2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Arsyetim

Lënda me numër 09-3777/1 e datës 03.11.2020 është lëndë e formuar në bazë të denoncimit nga parashtrues i panjohur kundër personit ///, i cili është zgjedhur anëtar i Bordit të /// /// ///, me pretendimin se ka keqpërdorur pozitën dhe autoritetin zyrtar si anëtar i bordit të /// /// ///, si dhe në të njëjtën kohë është themelues i kompanisë ///.

Në denoncim po ashtu thuhet se personi /// si themelues dhe menaxher i kompanisë /// ka hapur 6 (gjashtë) kazino elektronike me ekskluzivitet, përkatësisht licencë të kompanisë /// dhe me këtë realizon privilegje dhe përfitime për kompaninë e tij.

Pas shqyrtimit të denoncimit, KSHPK-ja konstaton se në rastin konkret /// nuk është rregullator i lojërave të fatit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në seancën e mbajtur më 02.11.2021, KSHPK-ja ka konstatuar se nuk ka juridiksion për veprime të mëtutjeshme në këtë rast, sepse nuk ka elemente të konfliktit të interesit.

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, Komisioni Shtetëror nuk ka elemente për veprime kompetente, prandaj u vendos si në dispozitën e këtij vendimi.

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**
Kryetar,
Biljana Ivanovska

Sipas përfundimit të KSHPK-së,
Punoi: EM, Këshilltar
Miratoi: K.N, anëtar i KSHPK - së

